



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. ____ Prot.,

Tiranë më ____ . ____ .2026

V E N D I M

Nr.6, datë 13.03.2026

PËR

**MOSRINOVIMIN E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL TË SIPËRMARRËSIT
VODAFONE ALBANIA SH.A, PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË BREZIT
2100 MHZ (SASI SPEKTRI 15 MHZ, I ÇIFTUAR DHE 5 MHZ, I PAÇIFTUAR)”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Dania Nallbani në mbledhjen e datës 13 mars 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it, miratuar me vendimin nr. 7, datë 16.2.2017 e ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Mosrinovimin e autorizimit individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz (sasi spektri 15 MHz, i çiftuar dhe 5 MHz, i paçiftuar)”.

BAZË LIGJORE:

1. Pika 1, Kreu IV, i vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 496, datë 22.07.2014, “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”.
2. Rregullore e brendshme e Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të KD të AKEP, e ndryshuar;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Pasi shqyrtoi materialin shkresor, të përbërë nga:

1. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
2. Relacioni shoqërues i projektvendimit

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Me Vendimin nr. 1453, datë 12.01.2010, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar dhënien e Autorizimit individual për përdorimin e frekuencave në brezin 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paçiftuar për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, për të ofruar shërbime të lëvizshme tokësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë” me afat vlefshmërie deri më 31.12.2025, i ndryshuar me vendimet e mëposhtme:
 - VKD nr. 2578, datë 22.06.2015 “Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. për përdorimin e frekuencave në brezin 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz, 1965-1970 MHz çiftuar me 2155-2160 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paçiftuar”, sipas të cilit miratohet heqja e kufizimeve teknologjike për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz.
 - VKD nr. 21, datë 01.12.2017 “Mbi dhënien e Autorizimeve Individuale rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a. tek sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a.
 - VKD nr. 4, datë 25.05.2023 “Për pajisjen me Autorizime Individuale të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave”, i ndryshuar me VKD nr. 11, datë 12.10.2023,
2. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a. ka depozituar në AKEP shkresën Ref.: LEA/093/J.L LR, datë 15.10.2025 (Nr. 1491 prot. AKEP, datë 17.10.2025), “Shprehje interesi për rinovimin e të drejtave të përdorimit të spektrit në brezin 2100 MHz”. Nëpërmjet kësaj shkrese, sipërmarrësi ka shprehur interes për:
 - Rinovimin e të gjithë sasisë prej 15 MHz FDD, spektër i çiftuar
 - Mosrinovimin e sasisë prej 5 MHz TDD, spektër i paçiftuar.
3. Pas marrjes së shprehjes së interesit, titullari i AKEP, mbështetur në nenin 67 dhe 70 e në vijim të Kreut IX – Qasja në Spektrin e Radiofrekuencave të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 496, datë 22.07.2014 për “Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim” dhe Rregulloren e brendshme të AKEP, ngriti Grupin e Punës me urdhër nr. 315, datë, 04.11.2025 (nr. 1570/1 prot., datë. 04.11.2025) me qëllim zhvillimin e procedurës për vlerësimin e përmbushjes së kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz nga sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a.

4. Me vendim nr. 25 datë 14.11.2025, Këshilli Drejtues i AKEP, ka miratuar Raportin Përmbledhës të vlerësimit mbi përmbushjen e të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz, nga sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., shoqëruar me propozimin për çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual.
5. Në zbatim të pikës 7, të Kreut II, të VKM nr. 496/2014, i ndryshuar, Raporti Përmbledhës i Vlerësimit i Grupit të Punës, shoqëruar me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual, i është dërguar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për vijimin e procedurave të mëtejshme, të përcaktuara në këtë VKM.
6. Me vendim nr. 32, datë 22.12.2025, Këshilli Drejtues i AKEP, ka miratuar “Shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së autorizimit individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz (sasi spektri 15 MHz, i çiftuar)”.
7. Me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 18, datë 13.01.2026, është ngritur Komisioni ad-hoc për negociimin dhe rinovimin e autorizimit individual të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Vodafone Albania” sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz.
8. Bazuar në negociimet e zhvilluara në takimet negociatore të datës 21 janar dhe 27 janar 2026, palët nënshkruan Aktin Përfundimtar me nr. 343/6, datë 04.02.2026, për mbylljen e procesit të negociimit midis Komisionit Ad Hoc dhe sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a., pa Akt Dakordësie, pasi palët nuk kanë arritur marrëveshje mbi çmimin minimal të propozuar.
9. Në zbatim të pikës 1 të Kreut IV, të VKM-së nr. 496, datë 22.07.2014, “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrin”, AKEP, duhet të procedojë me mosrinovimin e Autorizimit Individual për sipërmarrësin “Vodafone Albania” sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz (sasi spektri 15 MHz, i çiftuar dhe 5 MHz, i paçiftuar)”.
10. Në zbatim të këtij vendimi, sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., duhet të lirojë brezin e frekuencave 2100 MHz (sasi spektri 15 MHz, i çiftuar dhe 5 MHz, i paçiftuar)”, miratuar me VKD nr. 1453, datë 12.01.2010.
11. AKEP, në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 54/2024 dhe VKM nr. 70, datë 06.02.2026 “Për miratimin e rregullave mbi procedurën e konkurrimit publik, për dhënien e autorizimeve individuale”, në vijim do të kryejë një proces konsultimi publik me palët e interesuara për kushtet e përdorimit të këtij brezi frekuencash dhe procedurën që do të zbatohet për alokimin e brezit të frekuencave, 2100 MHz.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14 dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP:

V E N D O S I:

1. Mosrinovimin e Autorizimit Individual për sipërmarrësin “Vodafone Albania” sh.a., për përdorimin e brezit të frekuencave 2100 MHz (sasi spektri 15 MHz, i çiftuar dhe 5 MHz, i paçiftuar)”, miratuar me VKD nr. 1453, datë 12.01.2010, të ndryshuar.
2. Lirimin e brezit të frekuencave 2100 MHz (sasi spektri 15 MHz, i çiftuar dhe 5 MHz, i paçiftuar)”, miratuar me VKD nr. 1453, datë 12.01.2010, të ndryshuar, nga ana e sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a., brenda një periudhe kohore prej 6 muaj nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.
3. Ky vendim i njoftohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a.
4. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të AKEP.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka